



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 161, datë 18.05.2020

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ornela Naqellari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Nenet 319 e 25 të Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku dhe Artur Gaxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative së Apelit, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Lindita Hoxha (relatore), Vojsava Osmanaj dhe Aleks Nikolli, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Shoqëria {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Lindita Hoxha dhe Vojsava Osmanaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Shoqëria {...}, Shoqëria e Sigurimeve {...} dhe Shoqëria e Sigurimeve {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Aleks Nikolli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.
4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Aleks Nikolli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...} etj.; Objekti: “Dërgimin e çështjes për gjykim”.
5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Ankuese: Shoqëria {...}; Objekti: “Kundërshtim i vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Kundër: {...}; Objekti: {...} të datës 30.04.2018 “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr.727, datë 25.04.2018”.
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri (relator), Izet Salaj dhe Irena Brahimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: {...} për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr.1851/2019”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Izet Dushaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari {...}, çështjen gjyqësore me Ankues: {...} Objekti: “Kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 30.05.2019, të prokurorit {...} në lidhje me kallëzimin penal nr.294, viti 2019”.
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala dhe Shpresa Beçaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Ankuese: {...} Objekti: “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal që i përket kallëzimit nr.1097, viti 2019, të nxjerrë në datë 02.07.2019 {...}.
3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Izet Dushaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...} Akuza: “Plagosje e rëndë me dashje me pasojë vdekjen”.
4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Izet Dushaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...} Akuza: “Shpërdorim detyre”, “Kontrabandë me mallra të tjerë”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Izet Dushaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...} Akuza: “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municioneve”; “Kanosje”, etj.
6. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala dhe Shpresa Beçaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...} Akuza: “Vjedhje me dhunë”.
7. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxhaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...} Akuza: “Vetëgjyqësi”.
8. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Alaudin Malaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...} Akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”.
9. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala dhe Shpresa Beçaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...} Akuza: “Rebelimi i të burgosurve”.
10. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro dhe Zegjine Sollaku, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me Padi të: {...} Objekti: “Lirim dorëzim sendi, etj.” (Objekti i shqyrtimit: “Ankim ndaj vendimit të pezullimit”).

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Shkëlqim Mustafa, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria Lezhë; Të kallëzuar: {...} Objekti: “Pushim hetimesh”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Klodiana Gjyzari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...} Objekti: “Rishikim vendimi nr.385/2018 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë”.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Klodiana Gjyzari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...} Objekti: “Shqyrtim kërkesë për përjashimin e trupit gjykues”.
3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini dhe Klodiana Gjyzari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...} Objekti: “Rishikim vendimi”.
4. Gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Sokol Binaj (relator), Albana Boksi dhe Nure Dreni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...} Objekti: “Kundërshtim vendimi mosfillimi”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Albana Boksi (relatore), Sokol Binaj dhe Nure Dreni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...} Akuza: “Vrasje në lidhje me një krim tjetër, etj.”

6. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...} Akuza: “Trafikimi i narkotikëve”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Rexhep Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...} Akuza: “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, për veprën e kryer me datë 28.09.2019, dhe “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, për veprën e kryer me datë 16.10.2019, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...} Palë e interesuar: {...} Objekti: “Kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal datë 03.07.2018 të {...}”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Amarilda Sulaj (relatore) dhe Flutura Hoxha, si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Tonin Sterkaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Rishikimin e vendimit nr.144, datë 28.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor{...}”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Tonin Sterkaj (relator) si dhe gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Amarilda Sulaj dhe Flutura Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...} Objekti: “Rishikimin e vendimit nr.361, datë 31.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}dhe vendimit nr.37, datë 02.02.2015 të Gjykatës {...}, që ka lënë në fuqi me ndryshim këtë vendim dhe dërgim e çështjes për rigjykim nga një trup gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor{...}. Vendosjen e pezullimit të ekzekutimit të dënimit të vendosur me vendimin nr.37, datë 02.02.2015 të Gjykatës së Apelit{...}”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Maksim Qirjazi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...} Objekti: 1- “Kërkesë për pushimin e akuzës për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal ndaj të pandehurit {...};
2- “Kërkesë për miratimin e marrëveshjes së fajësisë dhe caktimit të dënimit për të pandehurin {...}për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Mirela Kore (Iliopulli), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}; Objekti: “Gjykimin e procedimit penal nr.49, të vitit 2020 kundër të pandehurës {...} e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Keqtrajtimi i të miturit”, parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i parë i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR